



BULETINI MUJOR

KOMUNA E LIPJANIT - ZYRA PËR INFORMIM

NIS NDËRTIMI I SHËTITORES TE PISHAT NË GADIME




Ky projekt do të financohet nga Komuna e Lipjanit dhe do të kushtoj rreth 180 mijë euro



Kryetari Imri Ahmeti, tha se ndërtimi i shtegut të ecjes që do të ketë edhe shtegun e bicikletave e ndriqimin publik për banorët e këtij regjioni është jashtëzakonisht i nevojshëm sepse edhe kështu frekuentohet për ecje e rekracion e ne sot filluam investimin ta plotësojmë me infrastrukturë të nevojshme dhe ta bëjmë të gatshëm për vizitorët e përditshëm ka thënë Kryetari Ahmeti.



Objekti i ri i Komunës së Lipjanit tashmë po shkon drejt përfundimit të punimeve, objekt ky i cili do të jep një pamje të mirë Komunës së Lipjanit duke ofruar një standard të ri të ofrimit të kushteve dhe nevojave të administratës komunale dhe shërbimeve ndaj qytetarëve.





Kryetari i Komunës së Lipjanit Imri Ahmeti së bashku me bashkëpunëtorët e tij, kanë nderuar Dëshmorin e Kombit Haradin Bajrami me rastin e 22 vjetorit të rënies

Kryetari Komunës së Lipjanit Imri Ahmeti, së bashku me familjen e Dëshmorit Haradin Bajrami kanë vizituar punimet në ndërtimin e shtatores së Dëshmorit Haradin Bajrami.

Kryetari Komunës Imri Ahmeti i shoqëruar nga përfaqësuesit e familjes së Dëshmorit Haradin Bajrami gjatë ditës së sotme ka qëndruar në atelenë ku po punohet shtatorja e Dëshmirt "Haradin Bajrami"



Një delegacion nga Komuna e Lipjanit i udhëhequr nga nënkryetari Fauz Xhemajli, kanë nderuar Dëshmorin Ramiz Shala me rastin e 22 vjetorit të rënies së tij duke bërë homazhe kanë vendodur edhe buqeta me lule tek kompleksi memorial në Kleqkë



Kryetari Imri Ahmeti me bashkëpunëtorë ka bërë homazhe në kompleksin memorial në Sllavi

Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti i shoqëruar me bashkëpunëtorët e tij, sot kanë bërë homazhe dhe kanë vendosur buqeta me lule tek varrezat e dëshmorëve dhe martirëve në fshatin Sllavi.



Homazhe në fshatrat Tërbofc dhe Grackë e Vogël



Delegacioni i Komunës së Lipjanit i udhëhequr nga nënkryetari Fauz Xhemajli ka bërë homazhe dhe ka vendosur buqeta me lule tek varret e dëshmores Zylfije Gashi dhe luftëtarit të lirisë Agron Gashi, në fshatin Tërbofc.

Po ashtu, ky delegacion sot ka vendosur buqetë lulesh edhe pranë pllakës përkujtimore të martirit Xhevat Rexhepi, në fshatin Grackë e Vogël.



Nderohen martirët e fshatrave Ribar i Vogël dhe Blinajë



Në nderim të 22-të vjetorit të rënies së martirëve, Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti bashkë me një delegacion të Komunës, gjatë ditës së kanë bërë homazhe dhe kanë vendosur lule në komplekset memoriale të martirëve në fshatrat Ribar i Vogël dhe Blinajë.



© 2006 The Authors
Journal compilation © 2006 Blackwell Publishing Ltd



Fillon vaksinimi i personelit mjekësorë në Lipjan



Në Komunën e Lipjanit ka filluar vaksinimi i personelit mjekësorë me vakësinën AstraZeneka këto vaksina janë të dedikuara për puntorët shëndetësorë, vaksinimi po bëhet sipas planit të komitetit të vaksinimit sipas të cilit në fazën e parë pas stafit mjekësorë me radhë do të jenë personat me moshat mbi 80 vjeç dhe ata me probleme shëndetësore, kronike.

Ky vaksinim po bëhet në kushtet dhe me masat e parapara sipas IKSHPK-së.



Po vazhdojnë punimet për e asfaltimit në rrugës “Sadik Shala” në Lipjan



Në Jetë të Re çdo ditë e më shumë po kompletohet infrastruktura rrugore, shumë rrugica tashmë kanë filluar punimet për asfaltim.



**Në fshatin Bujari shumë shpejt do të
kompletohet e gjithë infrastruktura rrugore, së
fundmi kanë filluar punimet për asfaltimin e
shumë rrugicave**



Komunës së Lipjanit tashmë po i shtohet edhe një poligon sportiv modern, së fundmi po punohet me intensitet të lartë në rregullimin e poligonit sportiv në Gjimnazin Ulpiana në Lipjan



Sikurse në shumë lokalitete të tjera edhe në Konjuh po punohet për rregullimin e rrugicave, së fundi kanë filluar punimet për asfaltimin e tyre.



Banorët e Bujarisë kanë falenderuar komunën konkretisht kryetarin Imri Ahmeti për përkushtimin e tij karshi qytetarëve.

Në vazhden e realizimit të shumë projekteve në teren. Komuna e Lipjanit së fundi ka filluar edhe me rregullimin e ndriçimit publik në hyrjen e qytetit të Lipjanit nga rrethrrrotullimi Lipjan-Magurë.

Ndriçimi publik është duke u shtuar çdo ditë e më shumë përveç qytetit së shpejti do të filloj edhe në disa vendbanime të tjera, projekte këto që do të ofrojnë kushte më të mira për qytetarët, sidomos në aspektin e sigurisë.



Komuna e Lipjanit dhuron rreth 2000 kontinjerë 120 litësh KRM"Pastrimi", njësia në Lipjan, me qëllim të lehtësimit të shërbimeve dhe cilësisë së tyre karshi qytetarëve lipjanas



Nga ana tjetër KRM"Pastrimi", ka falenderuar Komunën e Lipjanit për këtë donacion por edhe për gadishmërinë e bashkëpunimit në qdo kohë për kryrjen e punëve në teren.



Kryetari Imri Ahmeti bashkëbisedon me banorët për asfaltimin e rrugës Afrim Zhitia në Lipjan

Kryetari Imri Ahmeti ishte i pranishëm në këtë takim ku edhe ka bashkëbiseduar me pronarët të cilët ndikohen nga projekti i kësaj lagje lidhur me shpronësimin e pronave të paluajtshme që ndodhen brenda juridiksionit territorial të Komunës së Lipjanit.



Kryetari Imri Ahmeti ka kërkuar nga të pranishmit që të bashkëpunojnë të gjithë së bashku për evitimin e pengesave pronësore me qëllim të krijimit të kushteve për fillimin e punimeve në asfaltimin kësaj rruge, pasi që e njëjta nuk u plotëson kushtet për ndërtimin e një rruge me standarte.

Edhe në Komunën e Lipjanit është shënuar dita boterore e Autizmit!

KOMUNA E LIPJANIT



Psikologët e shkollave kanë organizuar shitjen e kartolinave të punara nga nxenesit e shkollave “Ismail Luma”, “Vëllëzerit Domaneku”, “Vëllëzërit Frashëri”, “17 Shkurti” si dhe fëmijet e çerdhës!

Mjetet e grumbulluara ju dedikohen personave me autizëm!

Me këtë rast drejtoresha e Drejtorisë Komunale të Arsimit në Lipjan Elmaze Behluli, ka falenderuar organizatorët për këtë aktivitet që ka për qëllim ndërgjegjësimin mbi autizmin, duke ju bashkuar motos “të gjithë të jemi të barabart në vendin tonë”.

KRYETARI KOMUNËS SË LIPJANIT, IMRI AHMETI SË BASHKU ME KRYETARIN E BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN, ZAIM BAFTIU KANË NËNSHKRUAR MARRËVESHJEN E BASHKËPUNIMIT PËR FINANCIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT KU KOMUNA E LIPJANIT DO TË VAZHDOJË TË BËJË MBULIMIN E SHPENZIMEVE PËR PROCESIN E VARRIMIT



Kryetari KBI-Lipjan ka falenderuar Kryetarin Ahmeti për bashkëpunimin e treguar dhe ka thënë se është shumë falenderues për gjithë angazhimin e tij për të ndihmuar qytetarët.

**KRYETARI IMRI AHMETI KA PRITUR NË TAKIM
DREJTORIN E ORGANIZATËS QATAR CHARITY,
MAHMOUD ABBAS SHAKER TË CILIN E
FALENDEROI PËR ANGAZHIMIN E TIJ, DUKE
OFRUAR MBËSHTETJEN PËR VAZHDIMIN E
PROJEKTEVE TË PËRBASHKËTA QË DO TË
JENË MES KOMUNËS SË LIPJANIT DHE
ORGANIZATËS QATAR CHARITY.**



**DREJTORIA E ADMINISTRATËS NË KOMUNËN
E LIPJANIT NJOFTON TË GJITHË QYTETARËT
SE NGA SOT E TUTJE ZYRJA E VENDIT NË
MAGURË ËSHTË ZHVENDOSUR NGA
LOKACIONI I VJETËR TEK QENDRA RINORE -
MAGURE**




"FUQIZIMI I TRANSPARENCËS MBI TË DREJTAT E NJERIUT"

Në kuadër të projektit "Fuqizimi i transparencës mbi të drejtat e njeriut", implementuar nga Instituti Kosovar i Medias dhe Komunikimit (IKMK) financuar nga Community Development Fund - CDF është mbajtur trajnimi lira e shprehjes dhe të drejtat e njeriut.



Kryetari Ahmeti pjesë e takimit virtual me Ministrin e Shëndetësisë, Arben Vitia dhe Ministrin e MAPL-së, Elbert Krasniqi



Kryetari i Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti ishte pjesë e takimit virtual me Ministrin e Shëndetësisë, Arben Vitia dhe Ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, ku është diskutuar rreth masave anti COVID-19, zbatimin dhe efektin e këtyre masave si dhe hapat e ardhshëm në këtë drejtim.

Kryetari Ahmeti në këtë takim ka prezantuar rekomandimet e pushtetit lokal ndaj pushtetit qendror lidhur me situatën pandemike dhe masat e reja në këtë drejtim, rekomandime këto të cilat janë dakorduar në takimin e djeshëm të Këshillit të Kryetarëve në kuadër të Asociacionit të Komunave.

DITA NDËRKOMBËTARE TË TOKËS, KOMUNA E LIPJANIT SË BASHKU ME TË RINJTË E ORGANIZATËS YAHIR SHËNUAN KËTË DITË MJEDISORE NË PARKUN E QYTETIT TË LIPJANIT



Shënimi i kësaj dite
më rëndësi të
veçantë për mjedisin
u mbajt në parkun e
qytetit me një
aktivitet simbolik
ngjyrosjen e ulëseve
në park me moton
“Ëndërro Gjelbër”.



DITA NDËRKOMBËTARE TË TOKËS, KOMUNA E LIPJANIT SË BASHKU ME TË RINJTË E ORGANIZATËS YAHR SHËNUAN KËTË DITË MJEDISORE NË PARKUN E QYTETIT TË LIPJANIT



Në kuadër të ditës së tokës, organizuar nga Drejtoria Urbanizimit, Drejtoresha Emina Rexhiq ka takuar nxënësit e shkollave fillore në Lipjan ku kanë diskutuar për planetin tokë dhe mbrojtjen e ambientit.



© 2006 The Authors
Journal compilation © 2006 Blackwell Publishing Ltd



Në këtë rast, Drejtoresha për Kulturë Rini dhe Sport, Anila Reçica duke i përshëndetur të pranishmit ka theksuar se kjo datë është edhe një thirrje për të rritur respektin dhe kontributet e pazëvendësueshme të autorëve të ndryshëm të librit.



KOMUNA E LIPJANIT PO BËNË INSTALIMIN I KAMERAVE PËR RRITJEN E SIGURISË NË SHKOLLA



Komuna e Lipjanit në kuadër të angazhimeve për rritjen e sigurisë në shkolla, së fundi ka vazhduar me instalimin e sistemit të kamerave "Shtjefen Gjeçovi" Janjevë, "Ernest Koliqi" Babush, "Hasan Prishtina" Llugaxhi, "Skënderbeu" Kraishtë, "7 Marsi" Poturoc, "17 Shkurti" Gllogovc, "Haradin Bajrami" Magure, QEAP "Çerdhja"



“SOFRA E RAMAZANIT”



Komuna e Lipjanit për nder të muajit të shenjë të Ramazanit ka mbështetur kampanjen “Sofra e Ramazanit”, të organizuar nga Këshilli i Bashkësisë Islame në Lipjan për t’u dalur në ndihmë familjeve në nevojë me artikuj ushqimorë.

Kryetari Imri Ahmeti gjatë aksionit të shpërndarjes së këtyre ndihmave ka falenderuar KBI në Lipjan për organizimin e kampanjës, “Sofra e Ramazanit”, duke thënë se ndihma dhe kujdesi ndaj famileve në nevojë është një mision shumë i rëndësishëm e sidomos pasi që jemi edhe në muajin e Ramazan.

Nga ana tjetër përfaqësuesit e KBI në Lipjan kanë falenderuar Kryetarin Imri Ahmeti për bashkëpunimin e vazhdueshëm e tash së fundi edhe në ndarjen e mjeteve financiare mbështjetjen e kësaj kampanje që do të thotë shumë sepse kujdesi i Institucioneve dhe bamirësve e begaton edhe më shumë sofrën e nevojtarëve.



MBAHET SEANCA E RADHËS E KUVENDIT KOMUNAL NË LIPJAN

Kuvendi Komunal i Lipjanit nën udhëheqjen e Kryesuesit Daut Azemi ka zhvilluar punimet e mbledhjes së 42-të. Mbledhje në të cilën u aprovuan pikat e rendit të ditës të cilat ishin propozuar për shqyrtim gjatë kësaj seance.

Fillimisht Kryetari Imri Ahmeti ka dhënë sqarime në të gjitha pyetjet dhe temat e ngritura nga anëtarët e Kuvendit Komunal, për të kaluar tek raporti i shpenzimeve dhe i të hyrave Janar -Mars-2021 të cilin e ka elaboruar drejtori për Buxhet dhe Financa Latif Ramadani.

Gjatë kësaj mbledhje po ashtu janë miratuar këto propozim vendime: Propozim Vendim për aprovimin e rezervës komunale 2021-2023, Propozim Vendim për lirim nga pagesa e qirasë joprofitabile të përfutuesve të banimit social, propozim rregullorë për taksat komunale. Propozim vendim për fillimin e procedurave për krijimin e Ndërmarrjes Publike Lokale "Ulpiana", Sh.a, Propozim vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare për fermerë si dhe pika shtesë e rendit të ditës Propozim vendimi për caktimin e lokacioneve për vendosjen e objekteve të përkohshme të shtatoreve për dëshmorët dhe veprimtarin e kombit.





BULETINI MUJOR



RR. SHQIPËRIA NR: 28 14000 LIPJAN, KOSOVË

TEL: 038 200 41 508

THIRR PA PAGESË 0 800 14 000

EMAIL: INFOKOMUNA.LIPJAN@RKS-GOV.NET